

VENDIM
Nr. 59 datë 18.4.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE BAZË TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 22, 51 dhe 97 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të ministrave nr. 519 datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenit 15 të “Rregullore për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016 dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 18.4.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.04. 2017, pasi shqyrtoi relacionin në lidhje me hartimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike.

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti